

Komponimet inorganike

Sipas vetive funksionale komponimet inorganike ndahen:

- 1.Okside
- 2.Acide
- 3.Hidrokside(baza)
- 4.Kripëra dhe komponime komplekse

OKSIDET

Oksidet janë komponime të oksigjenit me të gjitha elementet me përjashtim të gazrave inerte (fisnike)

Sipas vetive funksionale acidike ose bazike oksidet ndahet në:

1. Okside acidike
2. Okside bazike
3. Okside amfoterne
4. Oksidet neutrale ose indiferente


Oksidet acidike

Oksidet acidike ndryshe quhet okside të jometaleve, oksigjeni me jometal krijon oksid.

- Oksidet acidike kur veprojnë me H_2O japin **acide**.P.sh:



Oksidet acidike me **bazat** dhe oksidet bazike japin **kripëra**.P.sh:



Disa shembuj mbi emrat dhe formulat e oksidet acidike(jometaleve)

Dioksid karboni CO_2 trioksid sulfuri SO_3

dioksid sulfuri SO_2 pentaoksid difosforit P_2O_5

Oksidet acidike perfitohen duke larguar H_2O nga **acidet** prandaj quhen **anhidride te acideve** përkatsisht **acide** pa H_2O .

Oksidet bazike

Oksidet bazike ndryshe quhet okside të metaleve, oksigjeni me metal krijon oksid.

- Oksidet bazike kur veprojnë me H_2O japin hidrokside perkatësisht baza.P.sh:



Oksidet bazike me acide dhe oksidet acidike japin kripëra.P.sh:



Disa shembuj mbi emrat dhe formulat e oksideve bazike (metaleve)

Oksid kalciumi CaO Oksid hekuri (III) Fe_2O_3

Oksid kaliumi K_2O Oksid bakri (I) Cu_2O

Oksidet amfoterne

- Oksidet amfoterne janë okside të cilat sillen edhe si okside acidike dhe si okside bazike, pra në kushte të caktuara reagojnë edhe me acide edhe me baza dhe krijojnë **kripëra**.P.sh



Disa shembuj mbi emrat dhe formulat e oksideve bazike

Oksid zinku ZnO Oksid alumini Al_2O_3

Oksid antimoni (III) Sb_2O_3 Oksid kallai (II) SnO

Oksidet neutrale ose indiferente

- Oksidet neutrale janë okside që nuk reagojnë as me acide as me baza as me ujë
- Numri i oksideve neutrale është i vogël :
- Monoksid karboni CO
- Monoksid azoti NO
- Monoksid diazoti (suboksid azoti) N_2O

Nomenklatura(emërtimi) e oksideve

- Oksidet emërtohen sipas emertimit IUPAC së pari theksohet fjala oksid pastaj emri i elementit që ndërton oksidin dhe pas tij në kllapa të vogla dhe me numër romak shkruhet valenca.P.sh: te oksidet e metaleve

FeO –oksid hekuri(II) Fe₂O₃-oksid hekuri (III)

Cu₂O-oksid bakri (I) CuO-oksid bakri (II)

CrO₃-oksid kromi (VI) ZnO –oksid zinku

Oksidet e jometaleve emërtohen edhe sipas emërtimit IUPAK , edhe para emrit të elementit dhe fjalës oksid vihet parashtresa që tregojnë numrit të atomeve të elementit që ndërton oksidin dhe numrin e atomeve të oksigjenit

SO₂ -oksid sulfuri(IV) (dioksid sulfuri)

SO₃ - oksid sulfuri (VI) (trioksid sulfuri)

NO₂ - oksid azoti (IV) (dioksid azoti)

N₂O₅ - oksid azoti (V) (pentaoksid diazoti)

Detyra

.BaO ,N₂O₃ ,P₂O₃ ,Cl₂O₃ ,CaO, NiO ,Li₂O, NO Cl₂O, SiO₂

a)Emërto këto okside

b)Cilët prej oksideve janë okside te metaleve dhe okside të jometaleve

c) Cilat okside janë të lidhur me lidhje kovalente dhe jonike

Përgjigjet mi dërgoni ne email adresen krifcalaura@gmail.com

Linqet

<https://www.youtube.com/watch?v=SbVInIGixB8>

<https://www.youtube.com/watch?v=HZ35dAJRqEM>

https://www.youtube.com/watch?v=DRYbxWS_D8g

<https://www.youtube.com/watch?v=QkE3VD1PtTI>